YouthAct

YOUth FOR CHANGE

YOUth FOR CHANGE

Ngritja e Këshillit Rinor si Pjesë e Qeverisjes Vendore në Rrethin e Kurbinit

- Pse Rrethi Kurbin?
- Refleksione nga Antigona Llozhi
- Informim, Ndërgjegjësim, Ngritje Kapacitetesh
- Zëri i të Rinjve: Opinione dhe Sugjerime
- Kreativitet

Financuar nga:

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit "YOUth FOR CHANGE" i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Adresa: Rruga e Kosovarëve,
Nd. 37, H.1 Nr. 5, 1019, Tiranë, Shqipëri
(pranë digës së Liqenit Artificial)

E-mail: info@youthact.al
Web: www.youthact.al
Tel: +355 69 33 16 551

YouthAct Albania

Pse të rinjtë e Rrethit Kurbin

Rrethi i Kurbinit është njëri nga 36-të rrethet e Shqipërisë dhe bën pjesë në Qarkun të Lezhës. Rrethi i Kurbinit ka 54,000 banorë (sipas 2004) dhe kryeqendër Laçin.

Ky rreth përfshin nën administrimin e vet Bashkinë Kurbin, Njësinë Adminstrative Mamurras, Njësinë Administrative Fushë-Kuqë dhe Njësinë Adminstrative Milot.

Nga vëzhgimet e bëra në këtë rreth vërehet mungesa e aktiviteteve sociale, sportive dhe kulturore për të gjitha grupmoshat dhe kategoritë. Nga ana tjetër, shkalla e lartë e papunësisë, emigrimi, migrimi si dhe ekonomia informale në këtë rreth po ecin në hapa gjigandë.

Këto mangësira e problmatika mundësojnë lindjen dhe zhvillimin që në moshë të hershme të disa sjelljeve dhe qëndrimeve sociale që janë shumë larg parimeve të një shoqërie të shëndetshme e demokratike. Mungesa e mundësive të punësimit për të gjithë komunitetin, mungesa e inisiativave të organizatave jofitimprurëse për të përmirësuar jetën e komunitetit, shtimi i të rinjve pasivë dhe pa dëshira në angazhime komunitare, mungesa e aktiviteteve sociale e argëtuese etj. janë disa nga arsyet e përzgjedhjes së Rrethit të Kurbinit për t'u bërë pjesë e këtij projekti i cili synon forcimin e aktivizimit rinor dhe luftimin e pasivitetit. Ekspertë të fushës synojnë nxitjen e komunitetit për t'u angazhuar në nisma sociale si dhe në procese vendimmarrëse.

Ngritja e një Këshilli Rinor dhe aktivizimi i mekanizmave të tjerë për angazhimin e tij synon të ndërtojë një model të përfshirjes qytetare në Bashkinë e Kurbinit dhe konkretisht në grupe të margjinalizuara apo persona të mënjanuar e me mundësi të pakta.

Target grupi direkt i synuar janë nxënësit e 4 shkollave të Rrethit Kurbin dhe konkretisht gjimnazeve At Shtjefën Gjeçovi (Laç), Arif Halil Sulaj (Mamurras), At Shtjefën Kurti (Gore) dhe atij të Milotit. Në këtë mënyrë, projekti ka synuar përfshirjen dhe ndërgjegjësimin qytetar rinor në mbarë Rrethin e Kurbinit.

Përfituesit indirektë të projektit janë të rinj të tjerë të këtij rrethi që do të marrin informacion nga bashkëmoshatarët e tyre, të rionj të tjerë që do të përfshihen në aktivitete vullnetare si dhe grupe të tjera të komunitetit.

Refleksione

nga Antigona Llozhi

Qyteti im është një qytet me djem e vajza të jashtëzakonshëm, që shkëlqejnë në profesione si mjekësi, mësuesi, në biznes, në informatikë, ekonomi dhe shumë fusha të tjera. Një komb që nuk arrin të investojë në të ardhmen e rinisë së tij është një komb i dënuar, një komb i dështuar. Rinia është simbol i rëndësishëm i forcës dhe këmbënguljes. Rinia është e ardhmja e një kombi, ndaj mendoj se investimi më i mirë që mund të bëjmë është investimi në shkolla të reja e me kushte më bashkohore. Gjithashtu dhe vetmia e moshës së tretë, braktisur nga fëmijët që janë në emigracion është një dramë e kohës sonë. Kjo u shkakton atyre mërzi, stres e depresion. Ndihen të zhvlerësuar dhe pa ndonjë rol në jetë. Të moshuarit nuk mund të trajtohen për "mëshirë", por si zotërinj. Prandaj mendoj se hapja e një azili do të ishte zgjedhja më e mirë për moshën e tretë, sepse në fund të fundit do të ishte një investim që do tu shërbejë të gjithëve ,duam apo nuk duam, ajo është e "nesërmja".

Kujdesi për shëndetin është misionin më i shenjtë dhe delikat për njeriun dhe vetëm spitalet(mjekët) mund të kujdesen për shëndetin e cila lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ndjenjën e humanizmit dhe përgjegjësinë ndaj personave në nevojë. Në qytetin tim mungon një spital që ofron shërbimet mjekësore, për të gjitha moshat dhe me qëllimin e vetëm për të ofruar shërbime mjekësore të standartave bashkëkohore, ndaj mendoj që është një nga nevojat që Mamurrasi ka."

Antigona Llozhi
Shkolla e mesme "Arif Halil Sulaj"
Mamurras

Financuar nga:

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit
"YOUth FOR CHANGE"
i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Informim, Ndërgjegjësim, Ngritje Kapacitetesh

Projekti YOUth FOR CHANGE ka një titull simbolik e domethënës. Ai nënkupton që ndryshimi vjen nga you si youth.

Projekti është konceptuar në 3 faza dhe konkretisht:

- Faza e Parë synon Informim, Ndërgjegjësim, Ngritje Kapacitetesh të përfituesve direktë që janë nxënësit e gjimnazeve të Rrethit të Kurbinit.
- Faza e Dytë që synon **Gjithëpërfshirje Rinore** përmes pyetësorëve dhe mesazheve të shokëve e miqve të target grupit të identifikuar.
- Faza e Tretë që synon **Angazhim Komunitar** në dobi të grupeve në nevojë përmes aktiviteteve vullnetare.

Qendra Youth Act sëbashku me Koordinatoren Lokale dhe ekspertë përkatës përfundoi Fazën e Parë të projektit e cila synoi rritje të kapacitetit të të rinjve në lidhje me Aftësitë Komunikuese e Sjelljen Sociale, Aktivizmin dhe Lidershipin si dhe Angazhimin në Vetëqeverisje.

Në kushtet e pandemisë botërore këto trajnime u zhvilluan online. Kjo mënyrë e re e trajnimit në distancë nuk pengoi realizimin e qëllimeve të trajnimeve, përkundrazi i dha kohë të rinjve të përfshirë të jepnin opinione e sugjerime më efikase lidhur me:

- Arsyet pse zgjodhën të bëhen pjesë e këtij projekti,
- Situatën aktuale në komunitetin ku banojnë,
- Eksperiencën e tyre në angazhime të karakterit social e vullnetar,
- Idetë e tyre se si mund të organizonin një ditë aktivitet vullnetar në komunitet,
- 3 ndryshimet që do të sillnin në komunitet nëse do të ishin Kryetar Bashkie

Një element për t'u evidentuar deri në këtë fazë është se në përgjithësi vajzat janë më aktive dhe më të përfshira në aktivitete vullnetare.
Gjatë këtyre seancave të trajnimit u zhvilluan debate frytdhënëse ku nxënësit përmes argumantave mbronin idenë e tyre në mënyrë objektive. Ata shpalosën edhe tipare të lidershipit.
Gjatë tërë komunikimeve nxënësit janë ndërgjegjësuar për zhvillime të debatit të cilat lejojnë shpalosjen e sa më shumë ideve dhe të karakteristikave të gjithësecilit.

Bashkia e Kurbinit paraqet shumë vështirësi qoftë në infrastukturë, ashtu edhe në mundësi angazhimi shoqëror. Megjithatë këta nxënës shprehen lirshëm mbi të gjitha mangësitë dhe dëshirën që kanë për përmirësim të shërbimeve dhe krijim mundësish. Të rinjtë komentuan se mungesa e një Qendre Rinore përbën një problem që të rinjtë e Kurbinit të mblidhen e të diskutojnë mbi çështje të ndryshme që shqetësojnë komunitetin. Gjithashtu tregojnë se janë të vetëdijshëm e të vëmendshëm ndaj problemeve sociale. Prandaj angazhimin në këtë projekt e shohin si një mundësi shumë të mirë për të bërë diçka në përmirësim të situatës.



Financuar nga:

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Një projekt i Agjencisë Zvicerane SDC

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Ky publikim është prodhuar në kuadër të projektit
"YOUth FOR CHANGE"
i cili realizohet me mbështetjen financiare të LevizAlbania dhe është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC Mendimet dhe opinionet e shprehura në të i përkasin autorëve realizues dhe nuk përkojnë domosdoshmërisht me qëndrimet e donatorit.

Zëri i të Rinjve: Opinione dhe Sugjerime

3 gjërat që do të ndryshoni
në rast se do të ishit Kryetar Bashkie

AT SHTJEFEN KURTI - GORRE

Dritan Gjegjaj

1- Do të përmirësoja maksimalisht shërbimet sociale dhe ato shëndetësore.
2- Do të investoja në të gjitha fushat e aktiviteteve, por më parësor do të vija atë sportiv.
3- Do të investoja në përmirësimin e ambientit të plazhit të Adriatikut për të sjellë shumë vende pune.

Ilda Vuke

1- Do të ndërtoja kënde lojrash për fëmijë, parqe për fëmijë, të rriturit dhe të moshuarit.
2- Aktivitetet sportive në të cilat mund te zbulojmë talente të rinj.
3- Nuk do të kisha abuzuar kurrë, siç po bejnë sot.

Melisa Vuksani

1- Shtrimin e rrugëve në fshatra sepse shumica e tyre janë lënë në harresë.
2- Në shkolla, është e nevojshme pajisja me laboratore për lëndë të caktuara.
3- Ndërtimin e një këndi sportiv.

Vanesa Jakaj

1- Zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për të rinjtë.
2- Ndërtimin e parqeve dhe krijimie e mjediseve të nevojshme për argëtimin e fëmijëve.
3- Krijimin e shoqatave për të mbështetur dhe ndihmuar njerëzit në nevojë.



Brisilda Nikolli

1- Do të vendosja një institucion shëndetësor.
2- Do të bëja të mundur një vend ku mund te argëtoheshin fëmijët.
3- Do të vendosja disa rregulla për mbrojtjen e mjedisit.

Zëri i të Rinjve: Opinione dhe Sugjerime

3 gjërat që do të ndryshoni në rast se do të ishit Kryetar Bashkie

GJIMNAZI MILOT

Eneida Jaku

1-Rregullimin e infrastrukturës në shkollë.
2-Ndërtimin e një këndi argëtimi per fëmijët.
3-Rregullumin e pazarit që bëhet për të diela.

Erisa Preci

1- Ndërtimin e një këndi argëtimi për të rinjtë.
2-Të krijohen më shumë mundësi argëtimi për fëmijët.
3-Infrastukturën më të mirë për gjimnazin tonë.

Kujtim Veseli

1-Në çdo hapsirë toke ose ndërtese të prishur do të krijoja parqe per fëmijët dhe qendra rinore për adoleshentët.
2-Pazarin e Milotit do ta restauroja në mënyrën më të mirë të mundeshme.
3-Do të vendosja një ditë në vit për qytetarët e Milotit ku të gjithë vendasit të kontribuojnë për qytetin e tyre.

Romina Imeri

1- Shtimin e rolit të të rinjve në shoqëri.
2-Do t'i kushtoja vëmendje institucioneve arsimore.
3- Do të rrisja përkujdesjen për shtresat në nevojë të shoqerisë.

Sara Boci

1- Do të realizoja një pedonale që njerzit të kenë mundësi të ecin lirshëm.
2- Do të realizoja një palester në shkollë.
3-Do të krijoja nëpër shkolla laboratore për çdo lëndë mësimore.

Zëri i të Rinjve: Opinione dhe Sugjerime

3 gjërat që do të ndryshoni në rast se do të ishit Kryetar Bashkie

AT SHTJEFËN GJEÇOVI LAÇ

Artemida Markaj

1-Të zbatoheshin rregullat nga të gjithë në menyrë të barabrtë.
2- Të merren parasysh të gjitha ankesat nga të gjithë populli pa dallime.
3- Të jemi të gjithë së bashku të mbledhur për të nisur dicka dhe për ta perfunduar, jo për ta lënë në mes siç është bërë deri më sot.

Alfons Zymaj

1- Do të krijoja ambjente të përshtatshme sportive.
2- Do të përkrahja më shumë dhe do të investoja në zonat rurale dhe urbane.
3- Do të investoja në gjelberimin dhe mirëmbajtjen e ambjentit.

Eriola Hysa

1- Do të shtoja një qendër leximi ku të gjithë të rinjtë, po jo vetëm, kohen e lira ta kalonin duke lexuar.
2- Krijimi i një qendre rinore do të ishte fantastike.
3- Qendër për të rinjtë me aftësi ndryshe.

Alesia Ndreca

1- Stabilizimi i qytetarëve nëpër banesa dhe lidhja e pensionit për të siguruar kërkesat minimale të personave të prekur nga tërmeti.
2- Rigjelbërimin e kurorës së gjelber të kodrës ku ndodhet Kisha e Shna Ndout.
3- Rindërtimin e spitalit që u shemb nga tërmeti.

Zëri i të Rinjve: Opinione dhe Sugjerime

3 gjërat që do të ndryshoni
në rast se do të ishit Kryetar Bashkie

ARIF HALIL SULAJ - MAMURRAS

Anxhela Nelaj

1- Do të rregulloja shkollën ku marrin mësim rreth 600 gjimnazistë.
2- Do të bëja një lulishte më të madhe dhe një kënd lojrash për fëmijët e vegjël.
3- Do të bëja një qytet me ambjent te pastër pa mbeturina, me pemë, me gjelbërim.

Anita Leka

1- Shtimin e më shumë parqeve, këndeve të lojrave dhe biblotekave.
2- Mbjelljen e më shumë pemëve, vendosjen e koshave, pastrimin e qytetit, ngjitjen e posterave sensibilizues dhe të atyre me rregulla të cilët përmbajnë dhe ndëshkime
3- Shtimin e tabelave, semaforëve, vijave të bardha dhe përmirësimi i ndriçimit rrugor.

Armela Dema

1- Do të investoja më shumë në infrastrukturë.
2- Do të hapja më shumë vende pune.
3- Do t'i jepja më shumë rëndësi agrokultures.